




MBRETI ABDULLAH II IBN AL HUSSEIN, VIZITË ZYRTARE NË TIRANË

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Iglj Hasani ka mikpritur Madhërinë e Tij duke i uruar një vizitë zyrtare të suksesshme dhe të frytshme në Shqipëri. *"Shqipëria mbetet e përkushtuar dhe e bindur se, nën udhëheqjen e mençur të Madhërisë së Tij, partneriteti ynë me Mbretërinë Hashemite të Jordanisë do të vazhdojë të thellohet në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë."* – shprehet z. Hasani. Mbreti Abdullah II ibn Al Hussein është takuar me Kryeministrin Rama dhe Presidentin Begaj. Në fokus ka qenë forcimi i bashkëpunimit dypalësh, rritja e dialogut politik dhe thellimi ekonomik e tregtar mes dy vendeve.



POLONI, MINISTRI HASANI NË TAKIMIN "GYMNICH"

Varshavë, Ministri Hasani mori pjesë në Takimin "Gymnich" — një forum informal i Ministrave të Jashtëm të BE-së, i cili përfshin edhe partnerë nga vendet kandidatë. Gjatë takimeve të shpejta me homologë të ndryshëm nga BE-ja, z. Hasani shfrytëzoi mundësinë për të theksuar angazhimin e Shqipërisë për integrimin në BE. *"Ky rrugëtim mbetet i palëkundur dhe i pandërprerë. Puna jonë vazhdon me fokus dhe vendosmëri për të avancuar procesin e anëtarësimit."* – nënvizoi ai.



MIKPRITJE NË MEPJ E STUDENTËVE TË AKADEMISË DIPLOMATIKE TË VJENËS

Studentët të Akademisë prestigjioze Diplomatike të Vjenës u mikpritën nga Ministri Iglj Hasani. Në fokus të bashkëbisedimit ishin çështjet rajonale, kontekstet e reja gjeopolitike, sfidat që vijnë prej dezinformimit, momenti më i mirë historik që Shqipëria po kalon aktualisht në rrugëtimin e saj drejt BE-së, si dhe një sërë temash të tjera.



PROGRESI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL, MJET KYÇ NË PËRSHPEJTIMIN E PROCESIT TË INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Armand Skapi mori pjesë në Forumin vjetor të Iniciativës Adriatiko-Jonianë (AII) dhe të Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR), i zhvilluar nën Kryesinë Greke. Në fjalën e mbajtur ai shprehu vlerësimin për organizimin dhe përmbylljen me sukses të Kryesisë Greke. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si një instrument kyç për përshpejtimin e integritimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe vlerësoi kontributin e EUSAIR në rritjen e bashkëpunimit shumë-nivelesh, zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara dypalëshe dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale.



ZGJEDHJET PARLAMENTARE, HASANI PRET KOORDINATOREN E POSAÇME TË MISIONIT TË VËZHIMIT TË ZGJEDHJEVE TË OSBE-SË NË SHQIPËRI

Gjatë takimit, Ministri Hasani ka nënvizuar se Shqipëria mbetet e angazhuar për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme në përputhje me standardet e OSBE/ODIHR. *"Kjo nuk është vetëm një detyrë demokratike, por edhe një prioritet strategjik që lidhet me procesin e anëtarësimit të vendit tonë në BE. Kontributi dhe mbështetja e OSBE/ODIHR janë gjithmonë të rëndësishme sepse kontribuojnë drejtpërdrejt në vlerat dhe të ardhmen evropiane të Shqipërisë."* – është shprehur z. Hasani.




QEVERIA SHQIPTARE, TËRËSISHT E ANGAZHUAR NDAJ NJË PROCESI ELEKTORAL GJITHPËRFSHIRËS

Ministri Iglj Hasani mikpritë një grup deputetësh të Parlamentit Evropian, të cilët zhvilluan një vizitë zyrtare në Shqipëri në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të 11 Majit. Gjatë takimit, ai garantoj se qeveria shqiptare është tërësisht e angazhuar ndaj një procesi elektoral gjithëpërfshirës në frymë besimi e transparence, duke përfshirë respektimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR. *"Një mundësi e mirë gjithashtu për të diskutuar për hapat e shpejtë dhe momentin më të mirë historik të Shqipërisë në rrugëtimin e saj drejt familjes së madhe evropiane."* – shtoi z. Hasani.



KRYEMINISTRI RAMA MIKPRET KRYEMINISTRIN E MBRETËRISË SË BASHKUAR KEIR STARMER/ NËNSHKRUHEN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kryeministri Edi Rama mikpritë Kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar Keir Starmer, në vizitën e tij të parë në Shqipëri, e cila zhvillohet në kuadër të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunimit strategjik mes dy vendeve. Në kuadër të kësaj vizite dhe forcimit të bashkëpunimit mes vendeve u nënshkrua "Deklarata e Përbashkët Mbretëri e Bashkuar-Shqipëri për Avancimin e Bashkëpunimit Dypalësh mbi Prioritetet e Përbashkëta", si dhe "Deklarata e qëllimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në lidhje me eksportet në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimin industrial".



SHQIPËRIA, MIKPRITËSE E SAMITIT TË GJASHTË TË KOMUNITETIT POLITIK EUROPIAN

Më 16 Maj 2025, Shqipëria qëndroi në zemër të diplomacisë evropiane, teksa 47 udhëheqës të vendeve evropiane — së bashku me drejtuesit e organizatave kryesore rajonale dhe ndërkombëtare — u mbledhën në Tiranë për Samitin e Komunitetit Politik Evropian (EPC). i organizuar nën drejtimin e Kryeministrit Edi Rama.

Sipas Ministrit Hasani, *"Kjo është një votë e vërtetë besimi për rolin në rritje të Shqipërisë në skenën evropiane dhe një dëshmi i përkushtimit tonë për të thelluar këtë të sigurt, më të fortë dhe më të bashkuar. Ne jo vetëm që po afrohemi me BE-në, por tashmë po kontribuojmë në formësimin e së ardhmes së Evropës. Krenarë për hapat që kemi ndërmarrë, si dhe më të vendosur për rrugën që kemi përpara."*



FORCIMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS SHQIPËRISË DHE MOLDAVISË


Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Iglj Hasani, dhe Zëvendëskryeminstria për Integrimin Evropian të Moldavisë, znj. Cristina Gherasimov, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi që synon promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimin e njohurive në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Ndër të tjera, z. Hasani informoi znj. Gherasimov për momentin historik që po kalon Shqipëria në rrugën drejt BE-së, si dhe ranë dakord të intensifikojnë përpjekjet për thellimin e bashkëpunimit dypalësh.



PJESËMARRJE NË MESHËN E SHENJTË TË INAUGURIMIT TË SHENJTERISË SË TIJ, PAPA LEO XIV


Vatikan – Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Iglj Hasani, së bashku me Presidentin Bajram Begaj dhe Zonjën e Parë, patën privilegjin e jashtëzakonshëm të marrin pjesë në Meshën e shenjtë të inaugurimit të Shenjtërisë së Tij, Papa Leo XIV. *"Urime, Ati i Shenjtë—qoftë udhëheqja Juaj e frymëzuar nga urtësia, dhembshuria dhe shpresa e palëkundur për një botë më të mirë."* – ka reaguar në rrjetet sociale, Ministri Hasani.



MINISTRI HASANI NË ÇELJEN E JAVËS SË EVROPËS

Z. Hasani mori pjesë në çeljen e Javës së Evropës, ku ishte pjesë e diskutimit mbi identitetin evropian dhe se *"qfarë na bën evropianë?"*.

Gjatë këtij aktiviteti, Ministri Hasani u shpreh se: *"Evropa nuk është një aspiratë e mjegullt, por një realitet i përditshëm. Nuk është vetëm një ëndërr, është drejtimi ku duam të jemi. Për ne, Evropa është mbrojtja dhe promovimi i vlerave që ajo mshëron; ndërsa kemi intensifikuar përpjekjet tona jo vetëm për të qenë një vend anëtar formal i BE-së, por edhe për të formësuar një kapitull të ri të familjes së madhe evropiane."*



MINISTRI HASANI MIKPRET MINISTREN PËR ÇËSHTJET EVROPIANE TË DANIMARKËS

Gjatë takimit në mjediset e MEPJ me znj. Marie Bjerre, Ministri Hasani ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e Danimarkës në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, si dhe ka nënvizuar se *"presim me padurim të forcojmë më tej bashkëpunimin tonë gjatë Presidencës daneze të BE-së që fillon më 1 Korrik"*.


Ndër të tjera, z. Hasani shprehur i bindur se nën drejtimin e Danimarkës, procesi i zgjerimit të BE-të mbetet një prioritet i lartë në agjendën e Bashkimit Evropian.



BOSNJË-HERCEGOVINË, MINISTRI HASANI TAKIM PRODUKTIV ME HOMOLOGUN ELMEDIN KONAKOVIĆ

Në takimin me Ministrin e Punëve të Jashtme të Bosnjë-Hercegovinës, z. Elmedin Konaković, Ministri Hasani ka deklaruar se ka ardhur koha tashmë për të thelluar dialogun politik mes dy vendeve tona dhe për të zgjeruar bashkëpunimin ekonomik në fusha të ndryshme me interes të ndërsjellë.


"Shqipëria mbetet e angazhuar për një të ardhme të përbashkët evropiane të Ballkanit Perëndimor. Në këtë rrugëtim, Tiranë dhe Sarajeva do të vazhdojnë të qëndrojnë krah për krah për një rajon të paqës dhe të begatë." – është shprehur ai.



INAUGURIM - RIHAPET PAS NJË DEKADE AMBASADA E SHQIPËRISË NË SARAJEVË

Ky inaugurim ishte një moment domethënës në thellimin e partneritetit dhe miqësisë në rritje midis Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, pasi ambasada u rihap zyrtarisht pas një dekade.

Gjatë këtij aktiviteti, Ministri Hasani u takua gjithashtu edhe me personelin tonë ushtarak që shërben me neder në Misionin EUFOR Althea në Bosnjë-Hercegovinë, të cilëve i shprehu mirënjohjen më të thellë për kontributin e tyre në paqe dhe siguri.



SHQIPËRIA DHE BE-JA, KRAH PËR KRAH. HAPET ZYRTARISHT GRUP-KAPITULLI 3 I NEGOCIATAVE

Një gurtihelme i ri është hedhur me hapjen zyrtare të Grup-Kapitullit 3 - Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse - gjatë Konferencës së 5-të Ndërqeveritare të mbajtur në Bruksel.

Sipas Ministrit Hasani, *"Hapja e 8 kapitujve të rinj reflekton progresin e bazuar në meritë të Shqipërisë dhe është një tregues i qartë se sa shumë kemi arritur brenda një kohe shumë të shkurtër. Rrugëtimi ynë drejt BE-së nuk ka qenë ndonjëherë kaq i qartë apo më i vendosur"*.



SHQIPËRIA DO QË BALKANI PERËNDIMOR TË RRUGËTOJË SI NJË I TËRË DREJT BASHKIMIT EVROPIAN.

Në takimin me të Dërguarin e Posaçëm të Ministrisë së Jashtme Silvano Perini për Ballkanin Perëndimor, z. Anzëz Frangëz, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Iglj Hasani cilësoi se është në interesin e të gjithëve ta shohim Ballkanin Perëndimor si pjesë integrale të BE-së.

Në anën tjetër, të dy palët inkurajuan bashkërisht eksplorimin e rrugëve të reja që sjellin bashkëpunim më të zgjeruar mes dy vendeve tona në nisma rajonale dhe fusha me potencial të lartë.



MINISTRI HASANI TAKIM ME HOMOLOGUN IZRAELIT, GIDEON SA'AR

Izrael – Ministri Hasani zhvilloi një takim produktiv me Ministrin e Punëve të Jashtme të Izraelit, Gideon Sa'ar, në kuadër të Konferencës Ministrorë për Luftën kundër Antisemitizmit, organizuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA).

Gjatë takimit, z. Hasani deklaroi se Shqipëria qëndron e palëkundur kundër çdo forme antisemitizmi, si dhe kundër çdo shprehjeje të intolrancës apo paragjykitimit ndaj popullit hebre. Gjithashtu u bë një vlerësim pozitiv i marrëdhënieve dypalëshe mes dy vendeve tona dhe u shpreh gatishmëria për të vazhduar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët.



IZRAEL, MINISTRI HASANI TAKIM ME KRYETARIN E KNESSET, Z. AMIR OHANA


Gjatë bisedës konstruktive me Kryetarin e Parlamentit të Izraelit, z. Amir Ohana, të dyja palët theksuan bashkërisht rëndësinë e zhvillimit të ndërveprimit ndërparlamentar përmes inkurajimit të vizitave reciproke dhe shkëmbimit të përvojave.

Ministri Hasani ka nënvizuar se *"Futurimet direkte mes Shqipërisë dhe Izraelit - tashmë 5 herë në javë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e turizmit - janë një sinjal pozitiv për të avancuar bashkëpunimin mes dy vendeve tona në fusha të ndryshme si siguria, infrastruktura, shëndetësia, teknologjia, inovacioni, bujqësia e të tjera."*



IZRAEL, KONFERENCA MINISTRORE PËR LUFTËN KUNDËR ANTISEMITIZMIT

Gjatë kësaj konference, Ministri Hasani mori pjesë në sesionin "Trashëgimia kundër urrejtjes". Ai ndau me krenari historinë e Besës shqiptare – një trashëgimi guximi e nderi që frymëzon botën edhe sot.




BASHKËBISEDIM ME ANËTARË TË STAFIT TË SENATIT DHE DHOMËS SË PËRFAQËSUESVE TË SHBA-SË

Ministri Hasani mikpritë në mjediset e MEPJ anëtarë të stafit të Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së, si pjesë e programit *"Balkans Forward Congressional Fellowship"* të Këshillit Atlantik. Gjatë takimit u trajtuan pikëpamjet mbi zhvillimet më të fundit në vend, trajektorja euroatlantike e Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit Perëndimor, si dhe rëndësia strategjike e SHBA-së në rajon.



"RETREAT" DY-DITOR ME PËRFAQËSUES TË TRUPIT DIPLOMATIK NË SHQIPËRI DHE DREJTUES TË MEPJ

Ky aktivitet i organizuar në Vlorën turistike, shërbeu jo vetëm si një takim, por si një hapësirë më shumë për të shkëmbyer pikëpamje me njëri-tjetrin, ushqyer bashkëpunimin dhe shtuar përpjekjet në thellimin e partneritetit për një të ardhme më të mirë së bashku.



SHQIPËRI – FRANCË, KRYEMINISTRI EDI RAMA MIKPRET PRESIDENTIN E FRANCËS EMMANUEL MACRON. NËNSHKRUHEN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kryeministri Edi Rama mikpritë Presidentin e Francës Emmanuel Macron, në ditën e dytë të vizitës së tij në Tiranë, në kuadër të Samitit VI të Komunitetit Politik Evropian. Pas takimit mes tyre, në praninë e Kryeministrit Rama dhe Presidentit Francez Macron u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për krijimin e një projekti gjithëpërfshirës për turizmin e qëndrueshëm në raionin e Korçës. Ndërkohë është nënshkruar edhe deklarata e bashkëpunimit për Planin e Veprimit për Inovacionin Francë-Shqipëri. Këto marrëveshje realizohen në kuadër të bashkëpunimit të bashkëpunimit mes vendeve.



LUKSEMBURG, ZËVENDËSMINISTRIA SILDA ANAGNOSTI ÇEPE PËRFAQËSON SHQIPËRINË NË MINISTERIALIN E KËSHILLIT TË EVROPËS

Në këtë ministerial, Shqipëria theksoi mbështetjen e saj për Paktin Demokratik të Këshillit të Evropës, si dhe përsëriti se Shtetet Anëtare nuk mund të flasin për universalitet dhe njëkohësisht të përjashtojnë ata që mbrojnë parimet e Këshillit të Evropës. U nënvizua gjithashtu se anëtarësimi i Kosovës nuk është vetëm i drejtë, por edhe i domosdoshëm. Vonesa cenon besueshmërinë. Mesa zhi i Shqipërisë është i qartë: solidariteti, dinjiteti, uniteti dhe drejtësia janë e vetmja rrugë përpara.



ANTALIA, TURQI – ZËVENDËSMINISTRI ENDRIT YEZIRAZI PËRFAQËSON SHQIPËRINË NË TAKIMIN JOZVYRTAR TË MINISTRAVE TË JASHTMË TË NATO-S

Në fokus të këtij organizimi ishin përgatitjet për Samitin e ardhshëm të NATO-s në Hagë dhe diskutimi mbi objektivin e ri të shpenzimeve për mbrojtje.

Shqipëria riafirmoi përkushtimin e saj ndaj sigurisë kolektive dhe kohezionit të Aleancës.

NXËNËS NGA TUZI I MALIT TË ZI VIZITOJNË MJEDISËT E MEPJ

Fëmijë të shkollës fillore "Mahmut Leliq" nga Tuzi i Malit të Zi kanë vizituar mjediset e MEPJ, ku janë mikpritur nga Zëvendësmministret Silda Anagnosti Çepe dhe Mery Fino.

Përmes një bisedë të ngrohtë dhe miqësore, fëmijët shprehën krenarinë e tyre për origjinin shqiptarë, si dhe emocionet e vizitës së tyre të parë në Tiranë. Në fund të bashkëbisedimit, ata shprehën dëshirën për t'u rikthyer sërish në Tiranë duke marrë pjesë në aktivitetet e ndryshme kulturore.

BAKJUT, RUMANI – ZËVENDËSMINISTRIA MEGI FIINO NË TAKIMIN E PËRVITSHËM TË "FRIENDS OF EUROPE"

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë të ndryshëm, të cilët zhvilluan diskutime dinamike dhe frytdhënëse.

Zëvendësmnistria Fino ndau me pjesëmarrësit përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë në luftën kundër kërcënimeve hibride dhe trajtimin e Manipulimit dhe Ndryhyrjes së Huaj në Informacion (FIMI).